# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-479074**

VERSIONI 2

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Revolucioni Flamingo” nuk e ndal dot! Rama i prerë për Zvërnecin: Investimi do të bëhet, e vetmja që mund ta pengojë është.... (FJALA) |
| ADRESA | https://newsbomb.al/aktualitet/revolucioni-flamingo-nuk-e-ndal-dot-rama-i-prere-per-zvernecin-invest-i402248 |
| BURIMI | newsbomb.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 29 shtator 2026, 12:13:30 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 29 shtator 2026, 12:06:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | 105e4c6f2700feb9c5ddc87100eca075de1da127eba62f7bafc1d5dbc0cc15a8 |
| TEKSTI | a951977d43e27e6192ae65dcf9c3e76d0c1ebc2a9115ac69f865ff2a8fb349ff |
| PAMJA | b30a2d2309d5242d9e6786d2e956d4a5b588be61698d14ac7f8ea7a24e8f196a |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 77d09c387da044cf1e23b2d6760faed25fc8eb65d35d2f602856fa0c2b20f76c |
| E MËPARSHMJA | ce43c5465f1a8d46bebe142a183b1059afac273132b8b5e90166932ca4bc6826 |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/77d09c387da044cf1e23b2d6760faed25fc8eb65d35d2f602856fa0c2b20f76c

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Hapësire reklamuese



Aktualitet

29 Shtator 2026, 14:06

# “Revolucioni Flamingo” nuk e ndal dot! Rama i prerë për Zvërnecin: Investimi do të bëhet, e vetmja që mund ta pengojë është.... (FJALA)

Shkruar nga Newsbomb



Edi Rama, "Revolucioni Flamingo"

Në fjalën e mbajtur në samitin e Euronews 2026, kryeministri Edi Rama foli për synimet e së ardhmes për të rritur më shumë numrin e turistëve, e cila do të arrihet duke përmirësuar infrastrukturën dhe investimet në vend. Duke u ndalur në të ashtuquajturën “Revolucioni Flamingo” Rama theksoi në fjalën e tij se investimi në Zvërnec do të ndodhë dhe e vetmja gjë që mund ta ndalë është studimi i mjedisit, nëse sipas shkencës thuhet se dëmtohet mjedisi, në të kundërt punimet do të vazhdojnë.

*“Nëse ndërtimi do të vazhdojë apo jo kjo do të vendoset jo në rrugë por në bazë të shkencës që do të thotë se nëse do të kemi vlerësim të ndikimit në mjedis që na thotë se ku jemi në rregull e ku jemi gabim, do rregullojmë gabimet e do vazhdojmë. Nuk e vendos jo jo!”*, theksoi kryeministri në fjalën e tij.

Po ashtu, Rama përmendi dhe përzgjedhjen e Zvërnecit nga dhëndri i Trump, Jared Kushner për të investuar, ku hodhi poshtë aludimet se në këtë zgjedhje fshihen motive politike.

*“Duhet t’i them gjërat siç janë, e thoni ju në Euronews duke më ftuar mua. Në 10 vite më parë nuk do të ndodhte që një kryeministri t’i kërkohej eja eja në një samit për turizmin. Më duhet të flas për një histori suksesi, Shqipërinë. Arsyeja nuk është politike, dhëndri i Trump e pa shumë tërheqëse që të investonte në Shqipëri, ka lidhje për të bërë diçka: turizmin e brezit të ri që duhet të jetë rezultati i zhvillimit me natyrën. Mënyra se si zhvillohet duhet të mbështetet te nevoja për rigjenerim.”*, shtoi në fjalën e tij kreu i

Revista



Abonohu tani dhe lexoje

Lajmet e fundit



Showbiz & Lifestyle
Dhunoi Eduart Kuçin dhe e “reklamoi” në rrjet, Apeli nxjerr nga shtëpia Joz Markun (DETAJE)



Politikë
Socialistët nuk bëjnë prapakthehu për Zvërnecin, Balla ua thotë dhe gjermanëve, flet edhe për Vlora Hysenin: PS nuk është avokate e askujt

Zbulo më shumë artikuj

qeverisë shqiptare.

Në përmbyllje të fjalës së tij, kryeministri i Shqipërisë zbuloi se brenda pak ditësh ecuria e investimeve në Zvërnec do të bëhet publike duke dëshmuar kështu se projekti po zhvillohet me standardet e duhura dhe çdo veprim do të jetë transparent.

**Fjala e Ramës:**

*Duhet t'i them gjërat siç janë, e thoni ju në Euronews duke më ftuar mua. Në 10 vite më parë nuk do të ndodhte që një kryeministri t'i kërkohej eja eja në një samit për turizmin. Më duhet të flas për një histori suksesi, Shqipërinë. Arsyeja nuk është politike, dhëndri i Trump e pa shumë tërheqëse që të investonte në Shqipëri, ka lidhje për të bërë diçka: turizmin e brezit të ri që duhet të jetë rezultati i zhvillimit me natyrën. Mënyra se si zhvillohet duhet të mbështetet te nevoja për rigjenerim.*

*Idea që natyra do të kujdeset për veten nëse jemi ne aty dhe nuk bëjmë asgjë për të, është krejt e vjetëruar dhe është e pabazë. Kjo është ajo që po përpiqen të bëjnë krejt inxhinierët më të mirë. Natyra do të jetë ajo që del në pah, ku njerëzit do të kalojnë pushimet e shqiptarët do të marrin mbrapsht një ekonomi më të mirë.*

*Me atë që dimë deri më tani, me ekspertizën që kemi, duhet të jeni krijues, novator.*

*Nëse ndërtimi do të vazhdojë apo jo kjo do të vendoset jo në rrugë por në bazë të shkencës që do të thotë se nëse do të kemi vlerësim të ndikimit në mjedis që na thotë se ku jemi në rregull e ku jemi gabim, do rregullojmë gabimet e do vazhdojmë. Nuk e vendos jo jo!*

*Në Shqipëri ende nuk kemi vendosur të krijojmë bombë bërthamore apo të çojmë njeri në hënë, por të bëjmë gjëra të thjeshta.*

*Edhe njëherë, nëse shkenca thotë mos shkoni aty, do e lëmë. Për pak ditë çdo gjë do të bëhet publike. Ky është niveli më i lartë i transparencës, përmes së cilit kërkojmë që ta bëjmë Shqipërinë transparente.*

## Sondazh

Poll

## Lexo gjithashtu




E Martë 14:32

## Katastrofë ekologjike në Lushnjë, Bashkia than rezervuarin për të betonuar portat, por çon drejt ngordhjes mijëra tonë peshk (VIDEO)









Aktualitet

Skandali me sekretet shtetërore dhe marrëdhënia me Ergys Agasin, Vlora Hyseni kërkon heqjen e arrestit shtëpiak

E Martë 14:27 Newsbomb

Aktualitet

Nga punësimi pa kriter te pagesa e audituesve pa punuar, punonjësit e KLSH-së letër Begajt dhe Kuvendit: Mbikëqyrni institucionin! Ndryshe thuhet, ndryshe bëhet (DOKUMENTET)

E Martë 13:08 Newsbomb




E Martë 12:51 Newsbomb

## Gjendet një trup i pajetë pranë Urës së Farkës, dyshohet se e ka përplasur makina, detajet e para






Aktualitet

Shpërthim i fuqishëm në një pikë karburanti në Sarandë, dy persona të plagosur (EMRAT)

E Martë 12:44

Aktualitet

Sherr me thika në Maliq, plagoset një person, shkak janë bërë bagëtitë (DETAJE)

E Martë 12:19




E Martë 11:50

## Të shtëna me armë në Qafështamë, qëllohet drejt efektivëve të antidrogës




Aktualitet

Pas katër muajsh punë, Ilir Topi "liron" karrigen te Fondi i Detyrueshëm i Kujdesit Shëndetësor, ministrja Spahiu emëron sot pasuesen e tij (EMRI)

E Martë 11:02 Newsbomb




Aktualitet

Ministrja Spahiu mbledh drejtuesit e QSUT, i POROSIT për pacientët: Më shumë eficiencë dhe përgjegjësi, fokusi të jetë te fëmijët

E Martë 10:22 Newsbomb




E Martë 10:06 Newsbomb

## Bashkë me vëllanë VRAU 36-vjeçarin, tetë vite pas ngjarjes ARRESTOHET në Itali 28-vjeçari dibran, pritet t'i dorëzohet Shqipërisë (EMRI-NGJARJA)



Aktualitet

DETAJE nga shpërthimi që shoi gjashtë jetë në Athinë, çifti shqiptar në pritje të fëmijës, autoritetet dyshojnë për rrjedhje gazi (HETIMET)

E Martë 09:49



Aktualitet

Publikoi VIDEON duke drejtuar makinën në trotuar për të kapur "viralitet" në TikTok, e pëson beratasi, merr gjobë dhe i hiqet leja e qarkullimit

E Martë 09:44 Newsbomb




E Martë 08:47

Edi Rama në Samitin e Euronews për Turizmin në Bruksel: Shqipëria në fokus si destinacion turistik në zhvillim

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.